



Këshilla për kërkim të Banesës dhe dhomës

Kërkesat për banesa me qmime të volitshme në qytetin e Cyrihut janë të shumta. Prandaj kërkimi i banesës është punë intensive dhe kohë marrse. Nese ju anulohet marrëveshja për banim të tanishëm, filloni menjëher me kërkimin e një banesë të re. Një aplikim për banesë është si një aplikim për punë. Dosja duhet të bëj përshtypje dhe ti bie në sy pozitivisht qiradhënsit.

Si të veproni?

Kërkimi i Banesës

- Lajmerohuni te administrata e imobilijëve (Liegenchaftsverwaltung) edhe te kooperativa të ndërtimit (Baugenossenschaften); kërkoni mundësisht në shumë administrata edhe/ose kooperativa të ndërtimit (Baugenossenschaften) një **formular** për aplikim të banesës.
- **Interneti, p.sh.** www.homegate.ch, www.home.ch, www.immoscout24.ch, www.immoclick.ch, etj.
- **Përdorni të gjithat mundësit të rrethit tuaj, për të gjetur një banesë.** Tregoni të gjithë shoqërisë, të njofshmit, kolegve të punës, epror që po e kërkoni një banesë.
- Përdorni **tabelat me njoftime falas** në qendrat tregtare, shitore të lagjës, restorante, në qendrat e bashkësis dhe kulturës, shkolla dhe spitale, etj.
- **Kërkoni në gazeta të përditshme.** Lexoni shfaqjet e imobilijëve mundësisht të shumë gazetave.
- Në gazetën **Tagblatt të qytetit të Cyrihut (Tagblatt der Stadt Zürich)** gjeni çdo të merkure publikime të **banesave të qytetit të Cyrihut** www.stadt-zuerich.ch/wohnungen
- **Mos kërkoni vetëm afër.** Ju do të gjeni ma shpejt një banesë nese nuk kërkoni vetëm në lagjen e preferuar por në gjithë qytetin dhe jashta qytetit të Cyrihut.

Këshilla për procedurën e aplikimit

- Mbani parasysh që **formularin ta mbushni me kujdes dhe plotësisht**
- Së bashku me formularin e aplikimit të mbushur i dërgoni edhe të gjitha **shtesat** e kërkuara nga formulari.
Pothuajse gjithë kërkohet:
 - Kopja e dëshmis nga regjistri i borxhlinjve (Betreibungsregisterauszug), jo më e vjetër se 6 muaj (mund ta nxjerrni tek administrata e borxhlijeve në rrethin e banimit tuaj ; www.stadt-zuerich.ch/basta)
- Përveq kësaj mundë të kërkohet edhe:
 - Kopja e llogaris të taksave ose edhe
 - Kopja e llogaris të rrogës
 - Nese në papunësi: llogarin e të hollave ditore të papunësis (Arbeitslosentaggeld)
 - si pensionist/e: IV-/AHV- dispozitën ose librezën mbi përfitimet e pensionit
 - si përfitues/e i asistencës sociale: kërkoni tek punëtori/ja sociale përkatëse shkrimin mbi finanzimin e qiras/orientimi për qiradhënsit («Finanzierung des Mietzinses/Orientierung für die Vermieterschaft») i cili informon mbi lartësin e qiras, e cilla paguhet nga asistencë sociale, dhe i rrit përspektivat tuaja për të gjetur një banesë. Keni parasysh që në Komuna tjera mundë të vlejn lartësi të qiras të tjera.
- **Letër aplikim:** rekomandohet që formularit të aplikimit ti bashkangjitet një letër shoqëruese e shkurtër, në të cillën e përshkruani vetën, situatën e banimit si dhe arsyt e kërkimit të banesës. Nese keni shënime në dëshmin e regjistrit të borxhlinjve (Betreibungsregisterauszug) sqaroni atë dhe tregoni patjetër në qoftë se nuk ka të bëjë me shuma të qiras të papaguara.
- **Mbas aplikimit:** pyëtni rregullisht në intervale kohore në telefon ose personalisht. Pyëtni se kush është përgjegjës për aplikimin tuaj dhe si janë mundësit për ju. Kështu jeni në kujtim te personi përgjegjës dhe e tregoni interesin tuaj të vazhdueshëm për banesë.



2/2

Informata dhe mbështetje të tjera

Adresa të dobishme i gjeni në:

- **Internet** www.stadt-zuerich.ch/wegweiser → temë banimi («Wohnen»),
- Në **banakt informativ të qendrave sociale (Infotheken der Sozialzentren)** (www.stadt-zuerich.ch/sozialzentren)
 - Sozialzentrum Helvetiaplatz, Molkenstrasse 5/9, 8004 Zürich
 - Sozialzentrum Albisriederhaus, Albisriederstrasse 330, 8047 Zürich
 - Sozialzentrum Dorflinde, Schwamendingenstrasse 41, 8050 Zürich
 - Sozialzentrum Höggerstrasse, Höggerstrasse 24, 8037 Zürich
 - Sozialzentrum Selnau, Selnaustrasse 17, 8001 Zürich
- Në qendër informimi të departamentit social (Informationszentrum des Sozialdepartements), 044 412 70 00 ose izs@zuerich.ch.

Ndihmë për mbushjen e formularit dhe shkruarjën të letrave

Shërbime për shkrime në qendrat sociale (Schreibdienst): www.stadt-zuerich.ch/schreibdienst